



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
SJ-026
Prishtinë, më 4 prill 2018, në orën 14:00

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 4 PRILL 2018**

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Mufera Serbica-Shinik, nënkryetare e Kuvendit.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2018, sipas kërkesës së 40 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

1. Debat parlamentar lidhur me rastin e depërtimit të gjashtë (6) shtetasve të Republikës së Turqisë

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit me kërkesën e 40 deputetëve të Kuvendit për debat parlamentar lidhur me rastin e depërtimit të gjashtë (6) shtetasve të Republikës së Turqisë.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e propozuesit për debat parlamentar që ta marrë fjalën.

Deputeti Avdullah Hoti, në emër të 40 deputetëve të Kuvendit, tha se përfaqësuesit e institucioneve, brenda gjashtë muajve, po na shpijnë nga një krizë në tjetrën, nga një aferë

në tjetrën, nga një dështim në tjetrin, duke rrezikuar rezultatet e deritashme të shtetit tonë të ri, të arritura me djersë e me gjak të patriotëve, aktivistëve, luftëtarëve e qytetarëve të shumtë.

Ne të gjithë u shtangëm më 29 mars nga lajmi se gjashtë shtetas turq ishin kidnapuar dhunshëm në pikë të ditës, para nxënësve, kolegëve a familjarëve të tyre. Në vend që të intervistoheshin nga organet kompetente në Prishtinë, ata u deportuan me urgjencë në Turqi. Për një kohë, institucionet nuk konfirmonin nëse këta persona ishin dëbuar menjëherë apo mbaheshin në Kosovë. Në shtetin demokratik të Kosovës, atyre nuk iu lejua asnjë kontakt me familjarët dhe avokatët.

Agjencia për Inteligjencë, bazuar në nenin 6 të Ligjit për të huajt, kishte kërkuar revokimin e lejes së qëndrimit, me arsyetimin se “përbënin rrezik për sigurinë kombëtare”.

Si mund të përbënin rrezik njerëz që kishin arsimuar gjenerata të tëra?

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion i Ministrisë së Brendshme, të njëjtën ditë kishte revokuar lejet e qëndrimit. Në vendim, palët e pakënaqura kishin të drejtë ankese.

Për shkak të deportimit me urgjencë, ata nuk kishin pasur mundësi ankese. Kështu, shteti i Kosovës kishte shkelur pikën 3 të nenit 6 të Ligjit për të huajt.

Ata me nguti ishin deportuar me aeroplan të inteligjencës turke.

Konventat ndërkombëtare, në veçanti Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndalojnë rreptësisht dëbimin e individëve në shtetet në të cilat rrezikohet keqtrajtimi i tyre, posaçërisht kur kjo bëhet pa ligj dhe pa mundësi ankese.

Organizatave vendore e ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Fondacioni i të Drejtave të Njeriut me bazë në Nju-Jork, si dhe një pjesë e shoqërisë civile, reagueshin ndaj këtyre shkeljeve të të drejtave elementare njerëzore.

Më 29 mars kishte tejkalim të autorizimeve ligjore dhe kushtetuese dhe dështim në zinxhirit komandues. Prandaj, duhet të ketë përgjegjësi nga i gjithë zinxhiri komandues, që ka ekzekutuar apo lejuar (me heshtje apo pjesëmarrje aktive) këtë shkelje të ligjeve dhe konventave ndërkombëtare. Ai në fund e paraqiti tekstin e rekomandimeve prej katër pikave. Diskutimi i plotë i deputetit Avdullah Hoti është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hapi diskutimet për çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Lidhur me debatin parlamentar, diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Igor Simiq, në emër të GP të Listës Serbe; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate; Fikrim Damka, në emër të GP “6+”; ministri Abelard Tahiri, deputetët: Armend Zemaj, Adem Mikullovc, Rexhep Selimi, Faton Topalli, Shkumbin Demaliaj, Zafir Berisha, Mufera Serbica-Shinik, nënkryetare e Kuvendit, Driton Selmanaj, Andin Hoti, Drita Millaku, Milaim Zeka, Rasim Selmanaj, Islam Pacolli, Lumir Abdixhiku, Zenun Pajaziti, Sami Kurteshi, Enver Hoti, Lirije Kajtazi, Xhelal Sveçla, Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Shqipe Pantina, Muharrem Nitaj, Ilir Deda, Arbër Rexhaj, Haxhi Shala, Mimoza Kusari-Lila, Fitore Pacolli-Dalipi, Bekim Haxhiu, Korab Sejdiu, Shemsi Syla, Vjosa Osmani-Sadriu, Ismajl Kurteshi, Anton Quni, Arbërie Nagavci, Naser Rugova, Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, si dhe z. Mahir Jagxhilar, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e ftoi kryetarët e grupeve parlamentare që ta harmonizojnë tekstin e rekomandimeve.

Në fund, deputeti Avdullah Hoti e paraqiti tekstin e Propozim-rekomandimeve të harmonizuara me grupet parlamentare të PDK, GDP, AAK dhe Nisma.

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e propozuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 60,
Kundër -----0,
Abstenime -----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, nxori këto:

R E K O M A N D I M E

1. Të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar për ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq më 29 mars 2018.
2. Kërkohet nga grupet parlamentare që brenda tri (3) ditësh t'i dërgojnë në Kryesinë e Kuvendit emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë komision, në përputhje me Ligjin për hetime parlamentare.

3. Në funksion të ndriçimit të plotë të kësaj çështjeje, Kuvendi i obligon të gjitha institucionet relevante që lidhen me çështjen në fjalë që t'u përgjigjen kërkesave të Komisionit Hetimor Parlamentar.

4. Kuvendi e mandaton Komisionin Hetimor Parlamentar që ta shqyrtojë përputhshmërinë e procedurave të ndjekura lidhur me këtë rast me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 20:30.

Nënkryetari i Kuvendit:

Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale